



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.39/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave të kandidatëve në hapsira publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 500.00 (pesqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

#### A r s y e t i m

Me datën 22.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës(KDI) me të cilën pretendon se me datën 22.09.2017, në rrugën “Ramadan Rexhepi” në Ferizaj, monitoruesit e tyre kanë hasur në poster të kandidatëve për këshilltar komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, të ngjitur në hapësira publike përkatësisht në shtylla elektrike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1,pika b), të LPZ-së Ligji Nr. 03/L-073, duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur posterat e kandidatëve në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 23.09.2017, subjekti politik LDK thekson se ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) është e pabazë, sepse në kushte në të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, duke e pasur parasysh faktin se komunat nuk kanë arritur që, ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore, të krijojnë hapsira të veçanta për vendosjen e materialëve zgjedhore, vendosja në një shtyllë elektrike nuk do të duhej të trajtohet si shkelje.

Gjithashtu, ka theksuar se ka ndërmarr masat e duhura dhe ka evituar “shkeljen” e pretenduar nga kandidatja në fjalë.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se janë larguar posterat nga vendi ku kanë qenë të vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal të subjektit politik LDK-së, është vendosur në hapësirë publike përkatësisht në shtyllë elektrike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapësira apo në rrugë publike”*

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterit i kandidatës për këshilltare komunale, të subjektit politik LDK-së, janë vendosur në shtylla elektrike.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike Lidhja Demokratike e Kosovës ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posterat e kandidatës së këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre, shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e

palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

ZL.Anr.39/2017 më datën 25.09.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

**Gyltene Sylejmani**



**Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.**

